




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008), nenit 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr 013/491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 7 lidhur me nenin 21 të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr 01-013/1706 të datës 23/12/2016 Kryetari i Komunës së Vitisë, bien këtë:

## V E N D I M

### PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN DHE VLERËSIMIN E KËRKESAVE PËR NNDARJE TË SUBVENCIONEVE PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

#### I.

**EMËROHET** Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komunën e Vitisë.

Komisioni ka këtë përbërje:

1. Arian Alidema - Kryetar i komisionit,
2. Granit Abdylit - anëtar i komisionit,
3. Avdirrahman Haliti - anëtar i komisionit

#### II

Komisioni nga neni 1 i këtij vendimi, ka për detyrë që ti shqyrtoj dhe vlerësoj kërkesat për ndarje të subvencioneve për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në pajtim me Rregulloren për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve nr 01-013/1706 të datës 23.12.2016.

#### III

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunës së Vitisë.

#### IV

Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë momentale në të holla numër 02-013/127 i datës 04.02.2014.

#### V

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Shëndetësi,
2. Anëtarëve të komisionit
3. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS  
Sokol Haliti

